



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0043

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Gjafa Travel” SH.P.K. kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender – Transporti i nxenseve të shkollave Fillore të Mesme të ulëta – Relacioni Dresnik – Kline - Dresnik” me numër të prokurimit:634-25-8397-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Klines më 26/02/2026, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “Gjafa Travel” SH.P.K.me nr. 2026/0043, e datës 16/01/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender – Transporti i nxenseve të shkollave Fillore të Mesme të ulëta – Relacioni Dresnik – Kline - Dresnik”me numër të prokurimit:634-25-8397-2-2-1, ndërsa (AK) Komuna e Klinesi mbetet në fuqi vendimi i AK.

2.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Klinesë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender – Transporti i nxenseve të shkollave Fillore të Mesme të ulëta – Relacioni Dresnik – Kline - Dresnik” me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës sherbime.

Me 13.01.2026 OE “Gjafa Travel” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gjafa Travel” SH.P.K. me nr. 0043/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender – Transporti i nxenseve të shkollave Filllore të Mesme të ulëta – Relacioni Dresnik – Kline - Dresnik” me numër të prokurimit: 634-25-8397-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gjafa Travel” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Dëmtim i rëndë i buxhetit publik (Neni 1 i LPP-së)

OE RINORI TOURS SH.P.K. është shpallur fituese me çmim 276.00 euro, ndërkohë që oferta e GJAFJA TRAVEL SH.P.K. ishte 87.40 euro, dukshëm më e favorshme ekonomikisht.

Kjo përbën:

- shkelje të parimit të ekonomicitetit;
- shpenzim jo racional të fondeve publike;
- dëm të drejtpërdrejtë për buxhetin e Komunës së Klinës.

Mungesë e licencës ligjore për transport (Nenet 59, 65, 72)

OE fitues:

- nuk ka prezantuar Licencë C për transport publik brenda Republikës së Kosovës;
- ka vetëm Licencë B, e cila nuk është e vlefshme për transport publik brenda Republikës së Kosovës, por është vetëm për transport ndërkombëtar.

Mosplotësimi i këtij kushti bazë ligjor duhej të rezultonte me eliminim automatik të ofertës.

Dokumentacion i pavlefshëm dhe i skaduar (Nenet 66 dhe 72)

Janë konstatuar këto shkelje serioze:

- Certifikata mjekësore e shoferit Gjergj Bala me afat të skaduar;
- Autobusi me targa 03-173-IT pa regjistrim valid;
- Autobusi me targa 03-154-ID pa kontroll teknik 6-mujor.

Pranimi i këtyre dokumenteve bie ndesh me kërkesat ligjore dhe rrezikon sigurinë e nxënësve.

Mungesë e referencave dhe listës së punëve (Nenet 59 dhe 65)

Sipas Dosjes së Tenderit (pika 9.1 / 9.2), kërkohet:

“Prezantimi i kontratave, listës së punëve të kryera, referencave dhe procesverbaleve të pranimi teknik për periudhën trevjeçare.”

OE RINORI TOURS SH.P.K.:

- ka prezantuar vetëm kontrata;
- nuk ka prezantuar referenca;
- nuk ka prezantuar listë të punëve;
- nuk ka prezantuar procesverbale pranimi.

Kjo përbën mosplotësim të qartë të kriterëve teknike dhe profesionale.

Shkelje e parimit të trajtimit të barabartë (Neni 6)

Autoriteti Kontraktues:

- ka toleruar shkelje të rënda për OE fitues;
- ka anashkaluar ofertën ligjore dhe ekonomikisht më të favorshme të ankuesit.

Kjo përbën favorizim të paligjshëm dhe cenon konkurrencën e ndershme.

Shkeljet konkrete:

- Mungesë e Licencës C për transport publik brenda Kosovës;
- Certifikatë mjekësore e shoferit e skaduar;
- Autobus pa regjistrim;
- Kontroll teknik pa 6-mujor;
- Mungesë referencash dhe listë e punëve të përfunduara, siç është kërkuar me dosjen e tenderit (pika 9.1 / 9.2).

Oferta duhej të ishte REFUZUAR, jo të shpallej fituese.

Në bazë të sa u tha më sipër, kërkojmë që:

1. Të aprovohet kjo ankesë si e bazuar;
2. Të anulohet Vendimi B58 i Komunës së Klinës, datë 09.01.2026;
3. Të urdhërohet rishqyrtimi i plotë i tenderit, në përputhje me LPP-në;
4. Të pezullohet nënshkrimi i kontratës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 22/01/2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0043/2026, ndërsa me datë 29/01/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0043 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 09.01.2026.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “Gjafa Travel” SH.P.K. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2026/0043 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë- lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 42,550.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë Rinori Tours sh.p.k. Kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa **ekspertja shqyrtuese** ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.2025/1027. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.2025/1027, të datës 24.11.2025, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Rinori Tours” -Kline, tani i rekomanduar për kontratë kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së B58, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6,7, 59, 65,66 dhe 72 të LPP-së. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues Xhafa Travel pretendon se OE i rekomanduar për kontratë, Rinori Tours sh.p.k. nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, me arsyetimin se nuk ka prezantuar Licencë C për transport publik brenda Republikës së Kosovës, por vetëm Licencë B, e cila vlen ekskluzivisht për transport ndërkombëtar dhe jo për transport publik brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Tutje, OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ka dorëzuar certifikatë mjekësore të shoferit Gjergj Bala me afat të skaduar, autobusi me targa 03-173-IT është prezantuar pa regjistrim valid, ndërsa autobusi me targa 03-154-ID nuk posedon kontroll teknik gjashtëmuor. Sipas ankuesit, pranimi i këtyre dokumenteve bie ndesh me kërkesat ligjore dhe rrezikon sigurinë e nxënësve. Po ashtu, pretendohet se mungojnë referencat dhe lista e punëve të përfunduara, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit (pikat 9.1 dhe 9.2).

Pretendimet përmbledhen si më poshtë: Mungesë e Licencës C për transport publik brenda Kosovës; Certifikatë mjekësore e shoferit me afat të skaduar; Autobus pa regjistrim valid; Mungesë e kontrollit teknik gjashtëmuor; Mungesë e referencave dhe listës së punëve të përfunduara sipas dosjes së tenderit (pikat 9.1 dhe 9.2).

Ekspertja shqyrtuese, pas analizimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, sqaron se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka kërkuar Licencë C si kriter kualifikues siç pretendon ankuesi. Kërkesa e AK-së ka qenë që OE të dëshmojë se posedon automjete për transport të udhëtarëve me leje qarkullimi valide, si dhe dëshmi të gjendjes teknike të automjeteve jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj. Andaj, pretendimi se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon Licencë C është i pabazuar, pasi një kriter i tillë nuk është specifikuar në dosjen e tenderit dhe as në njoftimin për kontratë. Këtë vlerësim e bazoj në nenin 56, paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se:

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Po ashtu edhe nenin 40.12 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik është përcaktuar:

Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar certifikatë mjekësore të shoferit Gjergj Bala me afat të skaduar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas dosjes së tenderit, AK ka kërkuar që për stafin voztësit të prezantohen Leja e voztjes për kategorinë përkatëse që përputhet me automjetin; dhe Certifikata e gjendjes shëndetësore me validitet jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në dosjen e tenderit AK nuk ka specifikuar numrin e saktë të shoferëve, por duke marrë parasysh kërkesën për minimum dy (2) automjete, është e arsyeshme të kuptohet se kërkohen së paku dy (2) shoferë. OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka bashkëngjitur dokumentin “**4. Stafi.pdf**”, në të cilin dokument janë prezantuar katër (4) shoferë, të pajisur me leje voztjeje dhe certifikata shëndetësore. Ndërsa sa i përket Certifikata shëndetësore të shoferit Gjergj Bala është e lëshuar më datë 17.01.2025 dhe rrjedhimisht, rezulton me afat të skaduar në raport me datën e njoftimit për kontratë (12.09.2025). OE ankues nuk i ka marrë parasysh edhe tre emrave tjerë (shoferë) të cilët gjenden në dokumentin “**4. Stafi.pdf**”. Ku për tre (3) shoferët e tjerë të prezantuar me ofertë, dokumentacioni-dëshmitë e dorëzuar plotësojnë kërkesat e AK-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar autobusi me targa 03-173-IT pa regjistrim valid, ndërsa autobusi me targa 03-154-ID nuk

posedon kontroll teknik gjashtëmuor.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese sqaron se, sipas dosjes së tenderit, AK ka kërkuar dy mjete transporti , të prezantohen Librezat e regjistrimit dhe certifikata e gjendjes teknike të automjetit jo me e vjetër se 6 mujë.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në dosjen e tenderit AK ka specifikuar dy (2) mjete transporti. OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka bashkëngjitur dokumentin “**5. Makineria.pdf**” në të cilin dokument janë prezantuar pesë (5) mjete transporti-autobusë. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se autobusi me targa 03-173-IT është pa regjistrim valid, dhe autobusi me targa 03-154-ID nuk posedon kontroll teknik gjashtëmuor, OE ankues nuk i ka marrë parasysh edhe tre (3) automjetet e tjera të përfshira në dokumentin “**5. Makineria.pdf**”. Për këto tri 3 automjete –autobusë dokumentacioni i dorëzuar me ofertë i plotëson kërkesat e AK-së, përkatësisht autobusët me targa 03-981-JD, 03-225, GK dhe 03-585-IP posedojnë librezat të regjistrimit certifikata të gjendjes teknike. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka mungesë e referencave dhe listës së punëve të përfunduara sipas kërkesës së dosjes së tenderit (pikat 9.1 dhe 9.2). **Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese** sqaron se, sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë AK ka kërkuar:

Ekspertja shqyrtuese bazuar ne platformën e prokurimit sqaron se për këtë aktivitet të prokurimi AK me datë 06.01.2026, ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë, pasi që i njëjtit me ofertë ka dorëzuar kontrata dhe referenca të natyrës se ngjashme por nuk ka dorëzuar listën e kontratave sipas kërkesës së AK-së. OE i rekomanduar për kontratë me datë 06.01.2026 ka dorëzuar listën e kontratave të prezantuara ne ofertë. Kërkimi i sqarimeve nga ana e AK-së, sipas LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse, është i lejuar në rastet kur dokumentacioni i dorëzuar nuk është i plotë. Në rastin konkret komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime shitesë në përputhje me nenin 10 të Udhëzuesit nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurim publik, ku theksohet se; në rastet kur lista e kontratave nuk është dorëzuar, por janë dorëzuar dëshmi (referenca apo certifikata të pranimit të kontratave), mund të kërkohen informata sqaruese. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve -Udhëzuesi nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurim publik

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandoj që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar për arsye të dhëna në përgjigjet ndaj pretendimeve ankimor, ndërsa konsideroj se vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Andaj rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës, ta mbaj në fuqi vendimin e datës 09.01.2026.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli

Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Gjafa Travel” SH.P.K. të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që Autoritetit Kontraktues Komuna e Klines i lejohet të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit ““Ritender – Transporti i nxenseve të shkollave Filllore të Mesme të ulëta – Relacioni Dresnik – Kline - Dresnik”” me numër të prokurimit 634-25-8397-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - GJAFATRAVEL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: